



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 1081 Prot

Peshkopi, më 15.03 2023

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Zyra Vendore Arsimore Diber.

**Për Dijeni:** Prefekti i Qarkut Diber

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për dijeni Vendimin e Këshillit Bashkiak Diber Nr.33

**Datë:** 03.03.2023

**“Miratimi i linjave të transportit Përnezhe-Qendër Fushë-Allie, për nxënësit e shkollës 9-  
vjecare “Sali Demiri” Njësia Administrative Fushë-Çidhën ”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Afrim Mikli**



Adresa: | Bulevardi “Elez Isufi” Peshkopi, email: [bashkiadiber@gmail.com](mailto:bashkiadiber@gmail.com) tel: 0035521822935



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 33 date, 03/03 / 2023

**“Miratimi i linjave të transportit Përnezhe-Qendër Fushë-Alie, për nxënësit e shkollës 9-vjecare “Sali Demiri” Fushë-Çidhën, Njësia Administrative Fushë-Çidhën”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” neni 23/1 pika b, ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, kërkesës së ardhur nga Drejtori dhe nxënësit shkollës 9-vjecare “Sali Demiri” Fushë-Çidhën, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **03.03.2023** me 18 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e linjave të transportit **Përnezhe- Qendër Fushë-Alie** për nxënësit e shkollës 9-vjecare “Sali Demiri” Fushë- Çidhën, Njësia Administrative Fushë-Çidhën.
2. Njoftohet për zbatimin e këtij vendimi Zyra Vendore Arsimore Dibër dhe shkolla 9-vjecare “Sali Demiri” Fushë-Çidhën, Njësia Administrative Fushë-Çidhën.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Vendimi u shpall me datë **03.03.2023**.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT  
TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga PA DIBËR dhe mban nga dërguesi nr 355/1 prot  
datë 17.03.2023 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes ( lënda)

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr.hyrës prot 1086/1 datë 20.03.2023

Praktika u drejtohet për administrim:

-Znj/Z

-Znj/Z

-Znj/Z

-Znj/Z

me porosi në:

Administracioni muftitëri Qytet i Elbit  
Afati i përgatitjes së praktikës shkresore ( përgjigjes, ...etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë separat gjatëse

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore:

Peshkopi, më 20.03.2023 7

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS





1086/1  
Mbrojtja e Mbrojtjes  
20/03/23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr. 355/1.prot.

Peshkopi, më 17.03.2023

Lënda : Për vendimet nr. (33, 34,35, 36 dhe 38), datë 03.03.2023 të Keshillit të Bashkisë

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Pranë institucionit të Prefektit më datë 16.03.2023, janë depozituar vendimet nr. (33, 34,35, 36 dhe 38), datë 03.03.2023, vendime të cilat kanë të bëjnë kryesisht me miratim të linjave të transportit, për nxënësit e disa shkollave 9 vjeçare të ndodhura në Njesitë Administrative Fushë Çidhën, Melan dhe Tomin.

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimet e lartëcituarra, konstatova se ato kanë ardhur dhe prokolluar pranë nesh tej afatit të percaktuar me ligj për pasojë në vlerësim të ligjit nuk krijojnë asnjë pasojë juridike, me perjashtim të vendimit nr.38, datë 03.03.2023 me objekt "Për emërtimin e shkolles 9 vjeçare "Blliçe " në emrin Skënder Kuta", që është jashtë sferës së kompetencës së Prefektit të shprehet për ligjshmërinë e tij.

VKM nr.682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", pika 2, përcakton se autoritet përgjegjës për veprime është Njësia arsimore vendore, e cila mbështetur në numrin e mësuesve dhe nxënësve që planifikohen të përfitojnë nga shërbimi i transportit, në bashkëpunim me këshillat e qarqeve e njësitë bazë të qeverisjes vendore, miratojnë hartën e linjave, sipas largësive të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi.

Zyra Vendore Arsimore Dibër, nuk mund të vihet para detyrimit për zbatimin e kësaj vendimmarje në kushtet e mos respektimit të dispozitave ligjore të përshkruara më sipër, pa marrë paraprakisht pëlqimin apo miratimin e saj të shoqëruar me projektin përkatës. Në këto kushte vendimet e sipërpërmendura nuk mund të marrin pëlqimin e Prefektit, pavarësisht faktit se prej jush këto akte gabimisht janë kualifikuar si karakterit individual.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU

